

VENDIM
Nr.769, datë 4.11.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011,
MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrit, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerje ashensori.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha